



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:001403

Datë: 01.02.2023

Numri i dokumentit: 04127967

C.nr.103/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizionit Civil, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile të paditësit S. R. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 1,457.58€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur me datë 27.01.2023, në seancë publike, në prezencën e paditësit dhe të përfaqësueses të së paditurës, mori, ndërsa me datë 01.02.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S. R. nga Prishtina, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpërblimit jubilar paditësit, t'ia paguajë 1 pagë jubilarë, në lartësi prej 485.86€, me kamatë ligjore prej 8% (tetë përqind) në vit, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë me datë 08.01.2020 e deri në pagesën e plotë, si dhe shumën prej 20.00€ (njëzetë euro), në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së gjykuar si në pikën I të këtij aktgjykimi dhe atë në shumën prej 971.72€

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë më datë 08.01.2020, ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë 3 paga jubilarë, në lartësi të një page mujore prej 485.86€, e në total shumën prej 1,457.58€ (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë. Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar në SH.F.M.U “Asim Vokshi” në Prishtinë si mësimdhënës, dhe që nga hyrja në fuqi e kontratës kolektive më datën 18.04.2017, nuk i është kompensuar shpërblimi jubilarë në vlerë prej 3 (tri) pagave jubilarë.

Paditësi në seancën e mbajtur dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj të precizuar në seancë, duke i propozuar gjykatës që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të 3 pagave jubilarë në lartësi të një page mujore në shumën prej 458.86€, t'ia paguajë shumën totale prej 1,457.58€. Gjithashtu ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë shumën prej 20.00€ në emër të taksës gjyqësore për padi.

E autorizuar e të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë kundërshtimeve si në seancën e mbajtur, duke theksuar se një kompensim i tillë nuk është paraparë me Ligjin e punës, dhe se gjatë përgatitjes së buxhetit e paditura nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këto kompensime. Në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Kontrata e punës nr.prot.66, e datës 01.09.2014, Vërtetimi i datës 27.12.2019, si dhe Vërtetimi i datës 13.10.2022.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me

ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, e pas kësaj ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U “Asim Vokshi” në Prishtinë si mësimdhënës i lëndës së historisë. Sido që të jetë kjo dëshmohet edhe përmes kontratës së punës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës me nr.prot.66, e datës 01.09.2014.

Nga vërtetimi i datës 27.12.2019, dëshmohet se paditësi ka 31 vite përvojë pune tek punëdhënësi i njëjtë-SH.F.M.U “Asim Vokshi” në Prishtinë. Ndërsa nga vërtetimi i datës 13.10.2022, dëshmohet se paga e paditësit është 485.86€.

Prandaj këtë lloj kompensimi gjykata paditësit ia njohu në harmoni me nenin 35, par 8, nën par. 8.3. të KKAK-së ku përcaktohet se "punëtorët (anëtarë të SBAShK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: për 30 vite të përvojës në punë në vlerë të një page bazë".

Gjykata duke ju referuar KKAK-së, të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta e punëtorëve të arsimit në shpërblim jubilar, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi nga data 18.04.2017.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve i cili përcakton se kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e

dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'i kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me pretendimin e të autorizuarës të së paditurës se nuk janë nënshkruese të kësaj kontrate, gjykata vë në dukje nenin 2 par. 1.2 të KKAK-së, sipas të cilit përcaktohet se dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuptim të kësaj, të punësuarit në sektorin e arsimit nuk mund të vlerësohen ndaras, porse ata paraqesin të punësuar në një sistem unitar të arsimit, duke përfshirë nivelin qendror dhe lokal. Prandaj pretendimi për t'iu shmangur pagimit të obligimeve të marra përmes KKAK-së, do të ishte në kundërshtim me atë që është zotuar MASHT-i.

Gjykata vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi për faktin se paditësi tek e paditura ka 31 vite të përvojës së punës, ndërsa me nenin 35, par 8, nën par. 8.3. të KKAK-së përcaktohet se "punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: për 30 vite të përvojës në punë në vlerë të një page bazë". Në rastin konkret paditësi ka kërkuar 3 paga, që do të thotë se i takon vetëm 1 pagë e jo 3, andaj edhe është refuzuara pjesa përtej shumës së gjykuar.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00€.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.103/2020, më datë 27.01.2023

Përparim Zeka

Gjyqtar

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.